



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:261713

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474779

CP.nr.172/22

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit R.R nga fshati ..., Komuna e Mitrovicës kundër debitorit A.R, nga fshati ..., komuna Vushtrri, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri CP.nr.180/18 të datës 01.11.2018, jashtë seance me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit A.R nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, i ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri CP.nr.180/18 të datës 01.11.2018.

A r s y e t i m

Kreditori R.R e vajzërisë S..., ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit A.R nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë për pagesën e alimentacionit sipas titullit përmbartimor në shume prej 50 euro në muaj, duke filluar nga data 09.01.2018, e gjersa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore.

Debitori A.R nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kundërshtim me shkrim, me te cilin në tërësi e ka kundërshtuar propozimin për lejimin e përmbarimit, me arsyetimin se i njëjti është rast social, nuk ka mundësi financiare për pagesën e detyrimit sipas aktgjykimit të kësaj gjykate, po ashtu me arsyetimin se i njëjti nuk është shkaktarë për shkurorëzim, dhe kreditori dhe fëmijët janë në gjendje të mirë materiale, djali I madh punon, prandaj, mbi bazën e këtyre arsye, gjykatës I ka propozuar që propozimin e kreditorit ta refuzoj dhe aprovoj kundërshtimin e debitorit.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në kundërshtim.

Gjykata, me aktvendimin CP.nr.180/18 të datës 17.12.2018 ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar. Debitori kundër vendimit të lartcekur ka ushtruar ankesë, ku Gjykata e Apelit, përmes aktvendimit AC.nr.724/19 të datës 06.05.2019 ka aprovuar ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.180/18 të datës 17.12.2018 dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Në rivendosje, kjo gjykatë, me aktvendimin CP.nr.145/19 të datës 15.11.2021 ka refuzuar prapësimin e debitorit, i cili kundër aktvendimit të lartcekur ka ushtruar ankesë të cilën Gjykata e Apelit, përmes aktvendimit AC.nr.10575/21 të datës 04.04.2022 e ka provuar si të themeltë, ka anuluar aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.145/19 të datës 15.11.2021, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Në ri procedure, kjo gjykatë, me qëllim të evitimit të shkeljeve të theksuara nga Gjykata e Apelit, përmes aktvendimit C.nr.172/22 të datës 09.06.2022, ka ftuar kreditorin që në afat prej 3 ditësh ta plotësoj propozimin për përmbarim, ashtu që gjykatës t'ia dorëzoj dokumentin përmbarimor në origjinal apo në kopje të vërtetuar së bashku me vulën e plotfuqishmërisë dhe të ekzekutueshmërisë.

Kreditori, brenda afatit të caktuar nga gjykata, të njëjtës ia ka dorëzuar dokumentin përmbarimor në kopje të vërtetuar së bashku me vulën e plotfuqishmërisë dhe të ekzekutueshmërisë.

Gjykata pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit, në raport me provat në shkresat e lëndës dhe udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, propozimi për përmbarim, është ushtruar në bazë të dokumentit përmbarimor, dhe atë, aktgjykimi të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë

– Dega Vushtrri, C.nr.06/18, të datës 29.06.2018, i plotfuqishëm me datën 06.08.2018 dhe i ekzekutueshëm me datën 24.08.2018, dhe i cili aktgjykim, sipas vlerësimit të kësaj gjykatës është dokument përbarimor ashtu siç parashihet me nenin 22(1.1) ku parashihet “ *Dokumente përbaruese janë: vendimi përbarues i gjykatës...*, me nenin 23(1) ku parashihet “*Sipas këtij ligji vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurë gjyqësore...*, dhe 24 par.1 të LPP-së ku parashihet “*Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë me ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare*”. Pra, dokumenti përbarimor në bazë të të cilit është paraqitur propozimi për përbarim është vendim përbarues gjyqësor, dhe atë, aktgjykim, me të cilin është urdhëruar një bërje apo dhënie, pra është urdhëruar përmbushja e detyrimit, dhe i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm (ka skaduar afati për përmbushje vullnetare).

Po ashtu, sipas gjykatës, dokumenti përbarimor, është i përshtatshëm për përbarim konform nenit 27 të LPP-së, ku parashihet “*Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*” e që në rastin konkret, dokumenti përbarimor përmban të gjitha kërkesat nga neni 27 i LPP-së, ashtu që në të është treguar kreditori, debitori, është treguar objekti, mjetet, shuma, dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata, vlerësoi propozimin për përbarim edhe në kuptim të nenit 36 par.1 ku parashihet “*Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë*” dhe par.2 të po të njëjtit nen, ku parashihet “*Vërtetimin për përbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*” Gjykata bazuar në dispozitat e lartcekura, vlerësoi se dokumenti përbarimor është në harmoni me nenin 36 par.1 dhe 2, ashtu që i njëjti është dorëzuar në origjinal, ka klauzolën e formës së prerë dhe të përbarueshmërisë të dhëna nga gjykata që ka vendosur në shkallë të parë.

Gjykata, pretendimin e debitorit se i njëjti është rast social dhe i gjendjes së rëndë ekonomike e refuzoi si të pabazuar sepse debitori, edhe përkundër faktit që mund të jetë shfrytëzues i ndihmës sociale, i njëjti me asnjë prove nuk e ka dokumentuar këtë fakt ashtu që nuk mund të zbatohet neni 85 i ligjit 04/L-139 për procedurën përbarimorë dhe neni 14 i ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-139 për procedurën përbarimorë.

Pretendimet e debitorit se nuk ekzistojnë kushtet për pagesën e alimentacionit sepse kreditori ka kushte më të mira financiare se debitori, gjykata e refuzoi si të pabazuar pasi që në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së tij sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigoroziteti formal në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit bazë të cilit është i lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit që është objekt i përmbartimit konform nenit 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 69, 71 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CPP.nr.172/22, me datë 19.03.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.